



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 6/15

Prishtinë, më 30.1.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Bojan Mitić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Bardhyl Meta, Donika Kadaj-Bujupi dhe Fikrim Damka.

Munguan: Naser Osmani, Besa Gaxherri dhe Visar Ymeri.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Alexandra Fehlinger nga GIZ, Ramadan Islami nga GI, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, Albulena Mavraj - Epoka e re, Liridon Llapashtica- Gazeta Zëri.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj Zëvendëskryetare e parë e Komisionit

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2015;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Zëvendëskryetarja e komisionit – konstatoi se komisioni njëllojë miratoi rendin e ditës.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit

Zëvendëskryetarja e komisionit - konstatoi se komisioni njëllojë miratoi procesverbalet e mbledhjeve të kaluara, pa vërejte.

3. Miratimi i Planit vjetor të punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2015

Zëvendëskryetarja e parë komisionit - njoftoi se Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 26.01.2015, ka kërkuar nga komisionet parlamentare, të hartojnë dhe miratojnë planet dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2015 më së voni deri më 2 shkurt, ku pastaj Administrata e Kuvendit, duhet të hartojë Propozim-programin e punës së Kuvendit për vitin 2015, i cili do të procedohet për miratim në seancë plenare. Stafi mbështetës në konsultim me mua, ka hartuar një draft plan janë

përfshirë aktivitetet e rregullta të komisionit që parashihen të realizohen gjatë vitit, si: shqyrtimi i gjitha projektligjeve dhe amendamenteve të komisioneve funksionale në aspektin e vlerësimit të ndikimit buxhetor, në momentin kur i dorëzohen komisionit për shqyrtim, shqyrtimin e raporteve financiare të qeverisë për Buxhetin e Republikës së Kosovës. Komisioni, po ashtu do të diskutojë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018 dhe shqyrtoi Projektligjin e buxhetit vjetor për 2016. Ndër të tjera, sikurse edhe viteve të kaluara, Komisioni shqyrton raportet vjetore të institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend, për të cilat komisioni për buxhet dhe financa është komision funksional dhe raportet vjetore financiare të të gjitha agjencive të pavarura që raportojnë në Kuvend. Në draft-plan, sikurse edhe viteve të kaluara janë paraparë të bëhet mbikëqyrja e zbatimi të dy ligje. Njëri në pjesën e parë të vitit, ndërsa tjetri në pjesën e dytë të vitit. Ligjet nuk janë caktuar dhe është lënë që të vendos në komision. Për këtë qëllim e kemi përpara një listë të ligjeve që janë të miratuara, për të cilat komisioni për buxhet dhe financa është komision funksional dhe ne tani duhet të përcaktohem për dy ligje që do të monitorohen.

Donika Kadaj-Bujupi – sa i përket mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, propozojë që njëri ndër ligjet që duhet monitoruar të jetë Ligji për prokurimin publik në Republikën e Kosovës. Në listën që e kemi përpara, po e shoh se e kemi monitoruar këtë ligj në vitin 2013, por unë konsideroj që për shkak që brishtësisë dhe natyrës së ndjeshme të kësaj fushe është e nevojshme që në vazhdimësi të monitorojmë zbatimin e ligjit, që ti nxjerrim dobësitë e ndoshta në një të ardhme edhe të rekomandojmë ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji. E dimë se në të gjitha Raportet e Progresit në të kaluarën në vazhdimi Është thënë se ka pasur shumë ngecje në fushën e prokurimit publik dhe unë mendoj që kontributi jonë në këtë fushë, do të ndihmonte në tejkalimin e këtyre sfidave, dhe të shohim se a ka përmirësim prej vitit 2013.

Zëvendëskryetarja e parë komisionit - theksoi se ne e kemi monitoruar këtë ligj në vitin 2013 dhe kemi nxjerr një numër rekomandimesh, dhe unë mendoj që është më mirë me i shikue ato rekomandime që janë nxjerr dhe me kërkuë përgjegjësi nga qeveria dhe institucionet që iu adresohen, dhe pastaj të shohim a ka nevojë për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit. Gjatë monitorimit, grupi punues ka organizuar takim edhe me OJQ-të dhe ne e kemi marrë parasysh edhe rekomandimet e tyre, që janë përmbledhur në raportin e komisionit me rekomandime, që është miratuar në Kuvend.

Latif Gashi – meqë kam qenë kryesues i grupit punues në monitorimin ligjit, dhe dy anëtarët tjerë kanë qenë nga opozita, kemi realizuar të gjitha aktivitetet që kanë qenë të planifikuara në procesin e monitorimit, ku janë vizituar dhe kontaktuar institucionet të ndryshme qendrore, lokale dhe agjenci të pavarura dhe shoqëria civile, dhe në bazë të këtyre takimeve kemi nxjerrur rekomandimet për Kuvend. Ne tani mund ta fusim në plan të punës, por realisht nuk mundemi me bë më shumë se sa që kemi bërë. Por unë kisha sugjeruar që të analizojmë rekomandimet e komisionit dhe të shohim se sa janë zbatuar dhe në bazë të kësaj, të bëjmë plotësimet dhe ndryshimet e nevojshme. Por, unë propozoj, që një ndër ligjet për monitorim të jetë Ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, kur dihet se sot në Kosovë shumë organizata humanitare kanë futur mjete financiare, jashtë sistemit dhe kontrollit bankar dhe si rezultat këto mjete janë shfrytëzuar për qëllime tjera, dhe janë krijuar rryma radikale, që janë kërcënim jo vetëm për Kosovën, por edhe për botën.

Donika Kada-Bujupi – unë konsideroj që një punë e përfunduar në vitin 2013 dhe rekomandimet e dalura, duhet të përcillen se sa janë zbatuar, mirëpo kjo nuk e përjashton mundësinë që ne duhet të organizohemi dhe të bëjmë monitorimin e serishëm të ligjit, sepse prej vitit 2013, nuk kemi pa ndonjë përparim të dukshëm në këtë fushë, i cili e bënë të panevojshme vazhdimin e monitorimit të zbatimit të këtij ligji, por përkundrazi prej viti në vit, kemi marr raporte më të këqija, nga të gjitha palët, edhe nga operatorët që në fakt tregojnë se ka mungesë të transparencës, sa i përket respektimi dhe zbatimit të ligjit dhe rregullave në prokurimin publik.

Zëvendëskryetarja e parë – një çështje që kam dëshirë ta diskutojmë, ku do të ishte mirë të ishte prezent edhe kryetari i komisionit, ka të bëjë ligjin për bankat, e institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Ky ligj është miratuar me këtë emër, por gjykata kushtetuese, i ka shfuqizuar nenet që kanë të bëjnë me rregullimin e problematikës së institucioneve mikrofinanciare. Në mandatin e kaluar, në si komision kemi punuar me bankën qendrore dhe e kemi hartuar një draft të projektligjit, por që nuk ka arritur të miratohet në Kuvend, për shkak të kohës. Duke ditur problematikën e kësaj fushe dhe nevojën e rregullimit me ligj të veçantë, unë mendoj që do të ishte e rëndësishme që ne si komision funksional, të marrim iniciativën e hartimit të projektligjit dhe këtë mund ta bëjmë gjatë vitit.

Bardhyl Meta - unë mendoj dhe propozoj që një ndër ligjet për monitorim, të jetë edhe ligji për akcizën në produktet e duhanit. Në zbatimin e këtij ligji kemi mjaftë probleme dhe ne dimë se në kuadër të kësaj po na përvidhen disa çështja siç është ajo me naftën, ku çmimi tek ne mbetet më i larti në botë, dhe në mënyrën se si është bërë akciza për naftën është e njëjta gjë edhe të duhani. Nëse e shiqojmë dhe bëjmë krahasime, ne jemi të vetmit në rajon që e ka këtë problem me akcizën në duhan dhe kjo po ndikon në shtimin e çmimit të duhanit.

Labinote Demi-Murtezi - unë mbështes dy mendimet, të znj. Donika dhe z. Latif, se janë të rëndësishme të veçantë edhe ligji për prokurimi publik, por edhe ligji për mikrofinancat. Në këtë rast, po ashtu jam dakord me z. Bardhyl për ligjin për akcizën në produktet e duhanit, sepse është në pyetje prodhimi dhe mendoj se duhet ta kemi vëmendjen pak më të madhe edhe aktivitetin e shtuar në këtë drejtim. Duke pasur parasysh se në Gjilan kemi fabrikën e duhanit, e cila tash është riaktivizuar dhe mendoj se do të duhej ti kontribonim më shumë kësaj çështje. Por nëse është mundësia me i monitoruar të tri ligjet, pse mos ti bëjmë.

Zëvendëskryetarja e parë e komisionit – ne mund të vendosim të monitorojmë të tre ligjet, por në të njëjtën kohë mund të kërkojmë nga ministria përkatëse që të na raportojmë për zbatimin e ligjeve përkatëse. Këtë e parasheh edhe Rregullorja e Kuvendit, ku në bazë të së cilës, ministrat janë të obligueshëm me ardhur edhe me na tregu se deri ku ka shkuar zbatueshmëria ligjeve. Sa i përket ligjit të prokurimit publik, unë mendoj se kishte qenë mirë që paraprakisht, një grup punues të analizojë zbatimin e rekomandimeve të cilat i ka dhënë komisioni, pastaj të shohim për nevojën e monitorimit të serishëm.

Donika Kada-Bujupi – unë mendoj se ne duhet të fusim në plan të punës formimin e një grupi punues, i cili do të rishikojë rekomandimet dhe nivelin e zbatimit të tyre nga viti 2013, dhe pastaj grupi punues ti rekomandojë komisionit për nevojën e monitorimit të serishëm të ligjit, por kjo të bëhet në gjashtë mujorin e parë të vitit. Gjithashtu, përkrahu propozimin se edhe ligji për akcizën e duhanit është i rëndësishëm të monitorohet, pasi që shumë shpesh po kërkohet të rregullohet kjo çështje, dhe ne mundemi konkretisht, të mbikëqyrim zbatimin e këtij ligji dhe të nxjerrim rekomandime, të cilat do të obligonin ekzekutivin në zbatimin e ligjit.

Zëvendëskryetarja e parë e komisionit – në bazë të propozimeve që u bënë, unë konstatoi se komisioni vendos, që në pjesën e parë të vitit të monitorohet ligji për akcizën në produktet e duhanit, ndërkaq në gjashtëmujorin e dytë, ligji për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare. Gjithashtu, në plan të punës të përfshihet propozimi që të formohet një grup punues për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të komisionit me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për prokurimin publik në republikën e Kosovës, dhe në bazë të kësaj ti rekomandojë komisionit, për nevojën e monitorimit të serishëm të ligjit.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, zëvendëskryetarja e parë, konstatoi se Komisioni, njëzëri nxori këtë

Vendim

Miratohet Plani vjetor i punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa për vitin 2015, me plotësimet që u propozuan në mbledhjen e sotme.

4. Të ndryshme

Zëvendëskryetarja e parë – për anëtarët e rinj që janë në komision i njoftojë se GIZ –ja e ka përkrahur komisionin prej vitit 2009 dhe për neve ka qenë një përkrahje e madhe, na ka ndihmuar në përgatitjen e stafit, që ka qenë interes shumë i madh, po ashtu kanë angazhuar ekspertë ndërkombëtar dhe vendor për nevojat e komisionit, me rastin e shqyrtimit të projektligjeve, monitorimit të ligjeve, hartimit të rregullores së brendshme të komisionit, na është mundësuar të realizojmë vizita studimore për të parë praktikën dhe përvojat e vendeve tjera, dhe kemi pasur një mbështetje të madhe nga udhëheqësit dhe stafi i projektit të GIZ. Unë mendoj që është një ndihmë shumë e fuqishme që do të na ofrohet nga GIZ-i, edhe në periudhën e mbetur të projektit, deri në fund të vitit 2015.

Mbledhja përfundoi në ora 11:49

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Safete Hadergjonaj